



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE / MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE / MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE

REPUBLIC OF KOSOVA  
MINISTRIE E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
Social Insurance Administration  
Mr. Miroslav  
2461  
11.12.20

## KONTRATA

**TITULLI I KONTRATËS: Renovimi i objekteve ekzistuese ISSH dhe SHK, 2020**

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	209-20-6404-5-2-1
Nr i brendshëm	209-20-021-521

## **PJESA B: KONTRATA2 & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA**

### **PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA**

**MINISTRIA E PUNES DHE MIREQENIES SOCIALE**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëriën anë; dhe

**Grup i Operatorëve Ekonomik TOSI - V SH.P.K.; N.N. Injenering MSH, Fehmi Agani nr.24, -, PEJË**, (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

**Renovimi i objekteve ekzistuese ISSH dhe SHK, 2020**

me numër identifikues: **209-20-6404-5-2-1**, me numër brenshëm të prokurimit **209/20/021/521**

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

**Renovimi i objekteve ekzistuese ISSH dhe SHK, 2020**

#### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: **167123,10 €**; [njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzetë e tre euro, dhjetë cent/ Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe

---

<sup>2</sup> Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontratë" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

#### Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Feti Ibishi
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.12.2020
Vula:	




#### Për Kontraktuesin

Emri:	VLOR UKELLA
Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	
Data:	01.12.2020
Vula:	



#### Për Kontraktuesin

Emri:	Milazem Shala
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	01.12.2020
Vula:	

